



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:193277

Datë: 01.02.2024

Numri i dokumentit: 05274942

**2023:204353**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Shoresa Hoxha, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.4/24 të datës 30.01.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit A.B nga Hani Elezit dhe të dëmtuarit J.K nga Hani Elezit, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.1232/23 të datës 21.09.2023, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, me datë 01.02.2024, mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.4/24 të datës 30.01.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit, A.B nga Hani Elezit dhe të dëmtuarit J.K nga Hani Elezit.

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1232/23 e datës 21.09.2023 dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit A.B nga Hani Elezit, i lindur me datë 29.08.1991, me nr. personal: ..., për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka parashtruar pranë kësaj gjykate aktakuzën me nr. PP/II.nr.1232/23 të datës 21.09.2023, kundër të pandehurit A.B nga Hani Elezit, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Në bazë të kësaj aktakuze, me dt.27.11.2023, gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencë të prokurorit të shtetit Avdulla Abedini, të dëmtuarit dhe të pandehurit, të cilët janë pajtuar që lënda penale e evidentuar me nr. 2023:204353, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim, vendosi që çështja penale të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datë 30.01.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.4/24, në mes palëve në procedurë, dhe atë në mes të pandehurit A.B dhe të dëmtuarit J.K.

Andaj Gjykata, duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë, dhe konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

**DEGA KAÇANIK**

**2023:204353 datë 01.02.2024**

Sekretarja Juridike ,  
Shpresa Hoxha

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.